

Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Imzot Joani: Mos e braktisni Shqipërinë pasi është e pamundur të duash Perëndinë dhe mos të duash vendin që të ka lindur..



Imzot Theofani shpesh thoshte: ‘Nëse në jetën politike kryevepra ime ka qenë pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, në fushën e letrave kryevepra ime është Kremtorja.’”

Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Imzot Joani, na ka nderuar duke dhënë intervistën e tij të parë për gazetën “Tema”.

Është një bisedë e lirshme rreth besimit ortodoks, pagëzimit të tij të fshehtë gjatë komunizmit, ekzistencës së Kishës së fshehtë në atë periudhë, shkollimit të tij në SHBA nën kujdesin e At Liolinit, vlerësimeve të tij maksimale për Kryepeshkopin Anastas dhe rolin e tij të pazëvendësueshëm në ringjalljen e Kishës Ortodokse të

Shqipërisë, vlerësimeve mbi Fan Nolin, kulturën e tij, dashurinë për Kishën Ortodokse dhe rolin e tij në historinë e Kishës, si dhe për çështje të debatueshme si Natyrës së Madhe dhe Vija e Teodosit në Shqipëri.

Si asnjëherë më parë, lexuesi ka shansin të lexojë një intervistë tërësisht kulturore nga një Kryepeshkop i Shqipërisë, jeta e të cilit pasqyron historinë e krishterimit në Shqipëri dhe sfidat që ajo ka përballuar.

Ai rrëfen se si i ka rënë në dorë Dhiata e Parë në gjimnaz, në vitin 1974, si ka ndikuar ajo në jetën e tij, dhe më pas për pagëzimin e fshehtë nga At Kozmai, me dëshmitar Petro Zhejin, i cili u bë nuni i tij.

“Atë Kozmain e kam njohur nëpërmjet disa motrave besimtare me banim në Korçë, të njohura si motrat Cico, të cilat i njihnim përmes Theofan Popës. Së bashku me Petro Zhejin, që u bë nuni im, i kemi vizituar ato shpeshherë.”

Ai tregon se kontakti i parë me Kryepeshkopin Anastas ishte në vitin 1992, i rekomanduar nga Mitropoliti Dhimitër, një mik i ngushtë i Kryepeshkopit Anastas qysh nga rinia, i cili i tregoi për veprimtarinë e tij në Greqi dhe si misionar në Afrikë. Nëpërmjet tij u lidh me Kryepeshkopin, të cilit i tha se kur të përfundonte studimet, do të kthehej në Shqipëri.

Fortlumturia e Tij, Imzot Joan, rrëfen se gjatë studimeve në Boston u ndihmua nga At Artur Liolini dhe së bashku punuan për disa kohë në organizimin e Bibliotekës së Fan Nolit.

“Aty hasëm edhe disa tekste të shkruara nga ai, që tregojnë qartë se për të, kisha ishte më e rëndësishmja. Ai ka shkruar: ‘Nga të gjitha veprimtaritë e mia, dashuria ime e parë është kisha’. Ndërsa përkthimin dhe hartimin e Kremtores – një libër shërbesash që përmban psalmet, odet dhe troparët e vitit liturgjik ortodoks – e ka quajtur ‘kënaqësinë e tij më të madhe’ dhe ‘veprën, në të cilën janë përqendruar përpjekjet e tij më të mëdha shpirtërore, letrare, muzikore dhe intelektuale’. At Arturi më ka treguar se Imzot Theofani shpesh thoshte: ‘Nëse në jetën politike kryevepra ime ka qenë pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, në fushën e letrave kryevepra ime është Kremtorja.’”

Intervista është një dëshmi përpara shqiptarëve se Kisha jonë Ortodokse ka sot në krye të saj një Kryepeshkop të denjë, një shqiptar të ditur, të urtë dhe të përkushtuar ndaj Zotit, siç e meriton historia e krishterimit shqiptar.

Jeni lindur në një vend zyrtarisht ateist dhe në një shoqëri që e ndëshkonte lidhjen me fenë pas vitit 1967. Si ka qenë rinia juaj në ateizmin zyrtar të Shqipërisë dhe

kush ka qenë pika e kthesës drejt të qenit një besimtar ortodoks? Si e keni njohur priftin Kozma Qirio dhe kur e keni marrë vendimin për t'u pagëzuar? Si e ka pritur familja juaj atëherë këtë vendim? I njoftuat ata?

Imzot Joani: Rinia ime gjatë ateizmit ka qenë pak a shumë si e gjithë të rinjve në atë kohë. Ne u rritëm pa praninë e besimit institucional, por në shpirtin e çdo njeriu ndjehen dhe ndodhin gjëra të ndryshme, sepse ne nuk jemi kopje. Gjithsekush ka veçantinë e tij dhe rrugën e tij. Jeta jonë ka një vazhdimësi, ku e kaluara jonë ndikon në ngjarjet që na ndodhin tani, ose në të ardhmen. Takimi im i parë me besimin ndodhi në vitin 1974, kur isha në vitin e katërt të gjimnazit. Sapo kisha mësuar frëngjisht dhe më ra në dorë një libër - Dhiata e Re - në frëngjisht. Ai që ma dha nuk dinte se çfarë libri ishte. Kur e lexova, diçka ndryshoi thellësisht në shpirtin tim. Mënyra sesi ishte shkruar, fjalët e thjeshta të Zotit, por shumë të thella, më bindën për vërtetësinë e tij. Këto janë të vërteta psikologjike. Edhe kur dikush të tregon diçka, shpeshherë, mënyra si ta thotë të bind që është e vërtetë.

Në atë kohë nuk praktikohej ndonjë besim, të paktën tek të rinjtë që unë njihja. Nuk ishte se unë praktikoja një besim dhe pastaj u ktheva. Kontakti im me Ungjillin ishte besimi im i parë. Atëherë vendosa të pagëzohem, gjë që realizua pak më vonë. Prindërve nuk u thashë, jo sepse ishin kundër, por nuk doja t'i trembja. Por nëna ime e kishte kuptuar.

Atë Kozmain e kam njohur nëpërmjet disa motrave besimtare me banim në Korçë, të njohura si motrat Cico, të cilat i kemi njohur nga Theofan Popa. Së bashku me Petro Zhejin, që u bë nuni im, i kemi vizituar ato shpesh herë. Kemi vizituar gjithashtu edhe Atë Kozmain, i cili banonte në fshatin Bestrovë në Vlorë.

Në vitet 1979-1990 keni punuar në Spitalin Psikiatrik të Tiranës, në pavionin e rehabilitimit nëpërmjet terapisë okupacionale. Çfarë është kjo terapi dhe ka një lidhje lidhje mes këtij profesioni dhe përkushtimit tuaj ndaj fesë?

Imzot Joani: Terapia okupacionale përdoret në aspekte të ndryshme, për të ndihmuar njerëzit që të kapërcejnë problemet fizike, emocionale, shoqërore dhe ata që përballen me probleme të shëndetit mendor. Këta të fundit, mund të gjenden në një situatë të pamundur të punojnë, ose të krijojnë lidhje sociale, duke shkëputur lidhjet me ambientet jashtë tyre. Reabilitimi i tyre nëpërmjet angazhimit kërkon një kohë të gjatë dhe durim, ku përfshihen punë të lehta dhe psikoterapi. Lidhja mes këtij profesioni dhe përkushtimit ndaj fesë është e dukshme. Sepse çfarë është feja, në kuptimin e krishterë? Është përpjekja për rehabilitimin e njeriut

dhe restaurimi i lidhjes së këputur ndërmjet njeriut dhe Perëndisë. Etërit e Kishës e kanë parë gjithmonë Kishën si një spital për shërimin e njeriut dhe jo si një gjykatë për të dënuar të tjerët. Sepse Perëndia nuk e dërgoi të Birin në botë që të gjykojë botën, po që të shpëtojë bota me anë të tij - thuhet në Ungjill.

Si është një ceremoni pagëzimi ilegale? Ku u zhvillua dhe çfarë i mungon nga një pagëzim legal që bëhet sot?

Imzot Joani: Në kohë normale pagëzimi bëhet në kishë, ndërsa në kohë persekutimesh pagëzimi është bërë në fshehtësi. Nga ana kishtare nuk i mungon asgjë dhe është njësoj i vlefshëm, nëse është bërë nga një prift ose peshkop kanonik. Unë u pagëzova në bodrumin e shtëpisë së Atë Kozmait. Ishte ai, nuni dhe unë, ndërsa jashtë shtëpisë rrinte si roje djali i Atë Kozmait, Ilia, që sot është prift në Vlorë.

Çfarë ishte Kisha e fshehtë ortodokse shqiptare? Kush qëndronte pas saj? Sa e rrezikuar ka qenë organizata politikisht?

Imzot Joani:Termi Kishë e nëndheshme është një term i njohur, sidomos në vendet e Europës Lindore, që tregon veprimtarinë e fshehur fetare në kohën e persekutimeve. Në vendin tonë, ku persekutimi ishte jashtëzakonisht i egër nuk ishin grupe të organizuara, për shkak sepse pjesa më e madhe e hierakëve kishte ndërruar jetë dhe kishin mbetur pak priftërinj. Gjithsekush që ka jetuar në atë kohë e kupton sesa i madh ishte rreziku nëse dikush do të na denonconte. Kisha e nëndheshme, në të cilën isha përfshirë edhe unë, ishte një grup i vogël në Tiranë, në Korçë dhe në Vlorë. Pa dyshim që ka patur edhe në qytete e vende të tjera, por unë nuk i kam njohur, sepse gjithçka bëhej në fshehtësi të madhe.

Cilët nga hierarkët e Kishës Ortodokse të Shqipërisë keni njohur që kanë mbijetuar pas ndalimit zyrtar të fesë?

Imzot Joani: Nga hierarkët nuk kam njohur ndonjërin personalisht, ngaqë kishin ndërruar jetë. Por kam njohur vetëm disa priftërinj, ndërmjet tyre edhe Atë Kozmain.

Si arritët të ikni në SHBA më 1990? Kush ju lidhi me shkollën ku studiuat dhe kush ju ndihmoi për të marrë vizë?

Imzot Joani: Në vitin 1990, pas hapjes së ambasadave, u lejua të mernim pasaportat dhe shkova në Itali, së bashku me Petro Zhejin dhe një kushëririn e tij. Atje u pranuan si refugjatë dhe morëm vizë në ambasadën amerikane. Në Amerikë na u dha Karta jeshile (Green Card). Atje kontaktova Atë Artur Liolinin, i cili më ndihmoi

që Kryepeshkopata shqiptare e Amerikës të më jipte një bursë studimi, nga një fondacion i krijuar në kujtim të Imzot Theofan Nolit. Në Amerikë, për kishat ortodokse, janë dy shkolla të rëndësishme teologjike: Holy Cross Greek Orthodox School of Theology (Shkolla Teologjike Ortodokse Greke e Kryqit të Nderuar) në Boston, nën juridiksionin e Patriarkanës Ekumenike dhe Saint Vladimir's Orthodox Theological Seminary (Seminari Teologjik Ortodoks i Shën Vladimirit) në Neë York, nën juridiksionin e OCA (Kisha Ortodokse e Amerikës). Meqenëse Kryepeshkopata Shqiptare e Amerikës e ka qendrën në Boston, studjova në atë qytet



At Artur Liolini, që udhëhoqi Kishen Ortodokse të shqiptarëve në Boston

Keni bërë disa cikle studimesh teologjike në Boston. Mund të na i përmbledhësh ato?

Imzot Joani: Në Boston, u diplomova me “High Distinction” në MTS (Master i Studimeve Teologjike) në vitin 1993. Në 1995 shkova përsëri për të ndjekur studime të mëtejshme në Universitetin “Holy Cross Greek Orthodox School of Theology” në Boston. Në vitin 1997 u diplomova me “High Distinction” në MT (Master i Teologjisë, një master i avancuar, ekuivalent me kandidat i shkencave) po në Holy Cross, Boston.



Cili ishte kontakti juaj i parë me Kryepeshkopin Anastas? Sa i qartë keni qenë për personalitetin e tij të lartë para se ta njihnit? Sa ju ka motivuar në jetën tuaj njohja me të? A është ai njeriu që i dedikoni karrierën në hierarkinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë?

Imzot Joani: Kontakti im i parë me Kryepeshkopin Anastas ishte në vitin 1992. Njëri nga profesorët e mi, Mitropoliti Dhimitër, më vonë Kryepeshkopi Dhimitër, meqenëse ishte një mik i ngushtë me Kryepeshkopin Anastas, qysh nga rinia e hershme, më tregoi rreth veprimtarisë së atij në Greqi dhe si misionar në Afrikë. Nëpërmjet tij u lidha me Kryepeshkopin, të cilit i thashë që kur të mbaroj studimet do të kthehem në Shqipëri. Ai u gëzua dhe më përgëzoi. Në atë kohë gjendja në Shqipëri ishte e vështirë, por unë mendova se në Amerikë një prift më shumë apo më pak do të ishte njësoj, ndërsa në Shqipëri ishte një nevojë e madhe për klerikë. Për më tepër ishte vendi im ku kam lindur dhe ku jam rritur dhe ndjeja një detyrim. Këto ishin arsyet përse u ktheva.

Mendoj se shembulli i tij ka qenë i rëndësishëm për të gjithë klerikët e kishës sonë, përfshirë edhe mua. Dashuria e tij për Kishën dhe për të gjithë njerëzit, urtësia dhe përkujdesja për grigjën që i kishte besuar Perëndia, durimi dhe vendosmëria për të realizuar objektivat që i kishte vënë vetes për rindërtimin nga gërmadhat të kishës sonë, ishin gjithmonë një shembujt i gjallë, me shumë fuqi, për të frymëzuar të tjerët. U dorëzova nga ai si dhjak, prift dhe peshkop.

Ju keni filluar karrierën si pedagog në Akademinë Teologjike të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Ku janë sot studentët tuaj? Sa është përqindja e atyre që nuk e kanë braktisur përkushtimin ndaj Kishës?

Imzot Joani: Kur u ktheva në Shqipëri fillova të punoja si pedagog në Seminarin Teologjik të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Vitet që kam kaluar, si laik dhe më vonë si klerik, në seminarin ortodoks, që më vonë u ngrit në gradën e Akademisë Teologjike, janë vite të paharruara për mua. I kam dhënë mësim të gjithë brezave të parë të studentëve, shumica e të cilëve tashmë janë klerikë dhe tre prej tyre janë Mitropolitë – Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit, ai i Elbasanit dhe ai i Beratit.

Shumë primat ortodoksë vijnë nga shkollat e Athinës, Kostandinopojës dhe Moskës. Ju vini nga studime të thella në Boston. A është më liberale shkolla amerikane dhe a ka ndonjë peshë në formimin ortodoks diferenca mes formimit kulturor në këto shkolla?

Nga përvoja ime mund të them se, ndonëse studentët nga shkolla amerikane janë më mendjehapur, përsëri nuk janë liberalë. Megjithë ndryshimet kulturore, në formimin ortodoks nuk ka ndryshime. Në shkollat e larta ortodokse në Amerikë ka një seriozitet të madh në studimet dhe një kërkesë dhe pritshmëri ndaj studentëve. Ato janë shkolla të akredituara sipas standarteve të universiteteve amerikane dhe botojnë libra të rëndësishëm teologjikë më shumë se çdo kishë tjetër.



Ka një debat të madh mbi Kryepeshkopin e parë, Fan Noli, dhe kufirin e paqartë të tij mes politikanit dhe kryepeshkopit. A keni një mendim tuajin?

Imzot Joani: Imzot Theofan Noli ka qenë figurë poliedrike. Ai ishte pajisur nga Perëndia me talente të jashtëzakonshme. Ishte poet, përkthyes i pashoq, zotërues i shumë gjuhëve, ekspert i mirë i muzikës, në vecanti të asaj fetare, diplomat i shquar, politikan dhe mbi të gjitha njeri i kishës. Ai dha një kontribut të paçmuar për ndërgjegjësimin kombëtar dhe përgatitjen e autoqefalisë, si edhe të teksteve kishtarë.

Kur isha student në Boston, së bashku me Atë Artur Liolinin, punuan për disa kohë në organizimin e Bibliotekës së Fan Nolit. Aty hasëm edhe në disa tekste të shkruara nga ai, që tregojnë qartë se për atë kisha ishte më rëndësishmja. Ai ka shkruar: “Nga të gjitha veprimtaritë e mia, dashuria ime e parë është kisha”.

Ndërsa përkthimin dhe hartimin e Kremtores - një libër shërbese që përmban psalmet, odet dhe tropare të vitit liturgjik ortodoks - e ka quajtur “kënaqësinë e tij më të madhe” dhe “veprën, në të cilën janë përqëndruar përpjekjet e tij më të mëdha shpirtërore, letrare, muzikore dhe intelektuale”. Atë Arturi më ka treguar se Imzot Theofani shpesh thoshte: “Nëse në jetën politike kryevepra ime ka qenë pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, në fushën e letrave kryevepra ime është Kremtorja”. Këto fjalë të tijat e tregojnë qartë kufirin ndërmjet politikanit dhe kryepeshkopit.



Ortodoksia dhe patriotizmi shqiptar kanë qenë bashkëudhëtarë në formimin e shtetit shqiptar. Shumica e rilindasve tanë ishin ortodoksë. Hirësia e tij Anastas më pati thënë se një nga shkaqet e konvertimit të madh të shqiptarëve të jugut në bektashinj ka qenë mungesa e një Dhiate në gjuhën shqipe, që shkaktonte dhe mungesë të kulturës fetare tek ata. Sa ju duket e besueshme kjo?

Imzot Joani: Pa dyshim që mungesa e një literature në gjuhën shqipe ishte një nga faktorët kryesorë në konvertimin masiv të shqiptarëve. Por, mendoj, se shekulli 19-të ishte tashmë shumë vonë, duhet të ishin bërë disa shekuj më parë. Deri në fillim të shekullit XVII-të popullsia e krishterë ishte dominuese. Kthimi masiv ndodhi nga fundi i shekullit 17-të deri në fundit e shek 18-të. Mendohet se në këtë shekull u kthyen në myslimanë rreth treqind mijë shqiptarë. Arsyet kryesore ishin: përbuzja, keqtrajtimi, diskriminimi, sistemi i rëndë fiskal, si edhe dëshira për të patur përfitime. Por, nuk përjashtohen edhe arsye të tjera, personale apo kolektive, si edhe karakteri dhe psikologjia e shqiptarëve. Një shkak tjetër i rëndësishëm ka qenë edhe shkatërrimi i madh i kulturës së krishterë që u bë gjatë luftërave shqiptaro-turke në shekujt XV-XVI, në të cilat u shkatërruan kisha e manastire, biblioteka dhe kronika, që do të ishin mjaft të vlefshme, jo vetëm për studimet e sotme historike, por edhe për ruajtjen e ndërgjegjes historike të shqiptarëve. Vendi

mbeti thuajse pa klerikë dhe ata që mbetën, shpesh ishin të pakualifikuar. Një pjesë e popullsisë kthehej vetëm për shkak të disa grindjeve me klerin. Kthimi i ortodoksëve në islamizëm mori përmasa të mëdha në shekullin XVIII.

Në shekullin e 19-të ne kemi zgjim të nacionalizmit në Ballkan, frymëzuar nga idetë e Revolucionit francez. Në fillim këto ide të reja, duke zgjuar një ndërgjegje kombëtare, ndihmuan në luftën e popujve ortodoksë të Ballkanit për tu çliruar nga pushtimi turk dhe Kisha, duke përkrahur popullin e saj në këtë luftë, filloi të merrte tepër e më tepër një karakter etnik. Besimi dhe kombi u lidhën ngushtë dhe filluan të mos dalloheshin nga njëri-tjetri, duke krijuar një konfuzion të kategorive. Dhe ky konfuzion pati koston e tij, sepse më vonë, nacionalizmi, që në fillim ishte dukur si një forcë çlirimtare dhe i ndihmoi këta popuj në çlirimin e tyre kombëtar, u bë një faktor ndarje dhe urrejtje, duke u kthyer kështu në një konflikt etnik të pandërprerë.

Edhe popullsia ortodokse shqiptare, e cila nuk ishte shumicë, pati një ndërgjegjësime kombëtar dhe rilindësit ortodoksë u përfshinë për ta përhapur këtë ndërgjegjësime. Ata u përpoqën të përgatisnin literaturën për shkollat shqipe dhe literaturën fetare, ku vendin kryesor do e kishte Dhiata e Re. Përpjekja e tyre e madhe dha fryte, Të cilat i gëzojmë edhe sot.

Ju jeni një njohës i thellë i historisë së krishterimit tek ne. Na thuaj pak mbi historinë e kishave më të vjetra ortodokse në Shqipëri. Cilat janë ato dhe cilës periudhë i përkasin?

Imzot Joani: Tashmë dihet se krishtërimi u përhap në hapësirat ku jetonin shqiptarët qysh në shekullin e parë. Kemi dëshmi të shumta, të cilat e vërtetojnë këtë, si p.sh., peshkopi i parë i Durrësit ishte Shën Qesari, një nga 70 nxënësit e Krishtit; peshkopi që e pasoi, shën Asti, u martirizua në vitin 98 etj. Varret e vjetra të zbuluara jashtë mureve të Butrintit (shek II) tregojnë praninë e një komuniteti të hershëm të krishterë.

Gjithashtu, bazilikat e vjetra, sot të rrënuara, i kemi kudo në vendin tonë: në Durrës, Elbasan, Ballsh, Korçë, Pogradec, Sarandë, Delvinë, Butrint, Vlorë etj. Rreth 30 bazilika janë zbuluar në hapësirën gjeografike të banuara me shqiptarë. Cilësia e tyre dhe përmasat e mëdha tregojnë se në shek 5-të dhe 6-të arkitektura kishtarë ishte shumë e zhvilluar.

Po ashtu, Kishat e vjetra ortodokse, shtrihen pothuajse në tërë territorin e Shqipërisë. Po përmend dy nga kishat e vjetra, por numri është shumë herë më i madh. Kisha e Labovës së Kryqit, siç shihet sot, është kryesisht ndërtim i shekullit të 13-të gjatë kohës së Despotatit të Epirit, megjithëse një themel fillestar mund të

shkojë thellë në kohën e Perandorit Justinian në vitet 527-565. Kisha e Ristozit, në rrëzë të malit të Moravës, në juglindje të Korçës mendohet të jetë ndërtuar në vitin 896 nga Shën Klementi dhe rindërtuar në gjysmën e dytë të shekullit 14-të. Pushtimet e shumta sollën shkatërrime të mëdha dhe shumë kisha të datuara në kohë të ndryshme janë ndërtuar mbi themelet e një kishe akoma më të vjetër.

Kur ndodhi Ndarja e Madhe mes Kishave të Romës dhe Kostandinopojës? Si u nda territori shqiptar? A ka një vijë të qartë mes gjeografisë së katolikëve dhe ortodoksëve në Shqipëri?

Imzot Joani: Zakonisht përmendet viti 1054 si ndarja e madhe, por konfliktet kishin filluar më parë dhe debatet vazhduan edhe më pas. Ndarja ishte një proces që vazhdoi në disa shekuj. Arsyet ishin teologjike, eklesiologjike, kulturore dhe politike. Theodosi (347-395), ishte perandori i fundit që sundoi perandorinë romake të lindjes dhe perëndimit. Ndarja që iu bë perandorisë në lindje dhe perëndim dhe e ashtuquajtura linja e Theodosit, ngaqë u nda në kohën e tij, përkoi në kufirin që ndante perandorinë nga ana kulturore dhe gjuhësore: latinishtja në perëndim dhe greqishtja në lindje. Territori ku banojnë sot shqiptarët ishte në perandorinë e lindjes.

Nuk ka një vijë të qartë mes gjeografisë së katolikëve dhe ortodoksëve në Shqipëri, por mund të themi se ortodoksët janë më shumë në jug dhe katolikët më shumë në veri



Kisha e Labovës së Kryqit me një themel fillestar në kohën e Perandorit Justinian në vitet 527-565.

Pse Shqipëria pati në Mesjetë shkrimtarë dhe dijetarë katolikë, por nuk njohim të tillë ortodoksë? A ka pasur dhe janë identifikuar me grekë?

Imzot Joani: Pa dyshim që ka patur, por, meqenëse gjuha që përdorej në atë kohë në liturgji dhe në shkrimet teologjike, ishte greqishtja, është vështirë që autorët të identifikohen nga ana etnike. Por, gjuha shqipe në Kishën Orthodhokse, në periudhën para turke, duhet të jetë përdorur edhe më shumë se sa mendohet. Këtë konkluzion e nxjerrim nga disa dëshmi mbi arbëreshët e Italisë, të cilët siç dihet vinin nga besimi orthodhoks dhe në fillimet e tyre vareshin nga Patriarkana e Ohrit, nga ku vareshin edhe orthodhoksët e Shqipërisë, dhe pajiseshin me priftërinj nga kjo Patriarkanë. Marafioti, 1601, tregon se ata kishin sjellë me vete një traditë të përdorimit të shqipes në shërbesat fetare, dhe kjo traditë të paktën duhet të kishte qenë e shek. XIV-XV. Ndonëse autori nuk përmend libra, me të drejtë mund të besohet se ata duhet të kishin patur në përdorim libra në gjuhën shqipe. Dokumenti më i vjetër që kemi në këtë drejtim, gjendet brenda një Kodiku greqisht në bibliotekën Ambroziane të Milanos. Është një fletë me format 15 X 13.5 cm, brenda Kodikut me format 23.3 X 15.3. Në atë është një pjesë (perikope) nga Ungjilli i Matheut (27:62-66 – pjesë që këndohet të Premten e Madhe), Himni i Pashkës dhe urimi Për shumë vjet o Kryezot. Mendohet të jetë i shekullit XIV, datë

të cilën ka edhe kodiku.

Në Jug të Shqipërisë ka shumë toponime dhe emra njerëzish që tingëllojnë si veriore dhe i identifikojnë me katolikët. A është e vërtetë? Gjeni të tilla në Labëri, Zagori, Frashër, etj.?

Imzot Joani: Është e vërtetë që sot mund të tingëllojnë si katolikë, por këto emra janë në fakt varianti shqiptar i emrave të krishterë, përdorur si në veri ashtu edhe në jug. P.Sh. emri i kishave kushtuar Shën Gjergjit ka mbetur Shën Gjergj, ndërsa emrat e njerëzve në jugun ortodoks, nën influencën e greqishtes, ishin në shumicë Jorgo. Po ashtu, kishat quhen Shën Pjetri, Shën Mëhilli etj, por emrat janë Petro, Mihal etj.



Si është sot Bota Ortodokse përtej Shqipërisë? A mund të na jepni një panoramë të gjeografisë së Ortodoksisë në botë?

Imzot Joani: Bota ortodokse shtrihet kryesisht në Europën Lindore dhe në Ballkan, por ka gjithashtu një prani të rëndësishme në Lindjen e Mesme dhe në Afrikë, ku janë patriarkanat e vjetra. Gjithashtu, si pasojë e emigracioneve të mëdha, sot kemi një prani të madhe në të gjitha vendet e Europës perëndimore, në Amerikë, Australi etj. Popullsia ortodokse llogaritet në rreth 300 milionë.



Kryepeshkopi Anastas, që ringriti Kishen Ortodokse të Shqipërisë

Autoriteti i lartë i Hirësisë së Tij, Kryepeshkopit Anastas, e ringjalli Kishën dhe e zhvilloi atë. A ka mundësi të reja financimi dhe a ka një strategji afatgjatë për këtë?

Imzot Joani: Kryepeshkopi Anastas bëri disa hapa të rëndësishëm për të siguruar pavarësinë ekonomike të kishës ortodokse në Shqipëri. Me përpjekje të mëdha ndërtoi dy hidrocentrale, të cilët jo vetëm ndihmojnë Kishën, por edhe vendin, sepse janë një burim energjie të pastër. Ne do të përpiqemi, sipas mundësive tona, për të krijuar burime të reja financimi dhe për të ndërtuar një strategji afatgjatë.

Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme janë edhe donacionet e besimtarë, që vitet e fundit kanë filluar të rriten.

Cilat janë raportet tuaja me shtetin shqiptar? Çfarë problemesh të pazgjidhura keni me pronat? Cila është pesha e financimit të qeverisë në Kishën Ortodokse?

Imzot Joani: Raportet e Kishës me shtetin janë pak a shumë si të gjitha raportet ndërmjet komuniteteve fetare dhe shtetit. Kemi një marrëveshje me shtetin, e cila

është ratifikuar në parlament, por që nuk është zbatuar akoma në tërësinë e saj. Problemi me pronat është i një rëndësie të veçantë dhe duhej të kishte më tepër vullnet politik për zgjidhjen. Ato u sekuestruan me një dekret dhe mund të ishin kthyer, nëse egzistonte vullneti, me anë të një dekreti tjetër. Kështu nuk do të vazhdonim me gjyqe që zgjasin pafundësisht. Pronat janë të rëndësishme për komunitetet fetare, për të qenë të pavarura dhe mendoj se është një çështje që ka bëjë me sigurinë kombëtare, sepse nëse nuk do të jenë të pavarura ekonomikisht, do të ketë gjithmonë ndërhyrje nga grupime të tjera, të cilat nuk do të jenë gjithmonë dashamirëse ndaj vendit tonë.



Cilat janë raportet tuaja me besimet e tjera fetare në Shqipëri? A është harmonia fetare në Shqipëri e rrezikuar?

Imzot Joani: Kur flitet për fenë në Shqipërinë gjithmonë përmendet bashkëjetesa fetare, e cila është një thesar i madh i vendit tonë. Por si çdo gjë, ashtu edhe bashkëjetesa, nuk është statike. Asgjë në këtë botë nuk është e imunizuar nga ndryshimet, lëvizjet, rritjet dhe humbjet. Brezat e mëparshëm hodhën themelet dhe e zhvilluan këtë traditë. Është detyra e jonë sot dhe atyre që do të vijë, që ta ruajmë dhe ta forcojmë vazhdimisht, sepse ashtu si çdo pasuri ajo duhet mbrojtur dhe zhvilluar më tej për të mirën e të gjithëve.



Tani që jeni Kryepeshkopi më i ri i Kishës Ortodokse të Shqipërisë, a keni filluar të mendoni se me çfarë do të identifikohet epoka juaj në krye të kësaj Kisha?

Imzot Joani: Mendoj se duhet të përqendrohemi në disa drejtime: në ruajtjen e mësimëve të Zotit, të transmetuara nga apostuj deri në ditët tona, në unitetin e kishës, në forcimin e bashkëjetësës fetare, në përkujdesjen ndaj të gjithëve, sidomos ndaj atyre që janë të varfër, në nevojë, në sëmundje, në vetmi dhe të mënjanuar dhe në nxitjen e dialogut, si në atë pan-ortodoks, ashtu edhe në dialogun me të gjithë të tjerët. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë do të jetë miqësore dhe dëshiron të jetojë në paqe me të gjithë, duke ndjekur këshillën e Shën Pavlit: Nëse mundet, sa varet nga ju, të keni paqe me të gjithë njerëzit (Rom. 12:18).



Duke ju falënderuar për intervistën, a mund të kemi një mesazh tuajin për çdo të ri shqiptar që dëshiron të jetë një besimtar i devotshëm ortodoks?

Imzot Joani: Me respekt dhe me vlerësim ndaj tyre, dëshiroj t'ju japë të rinjve një këshillë atërore: ta duan vendin e tyre dhe të mos e braktisin, sepse është e pamundur të duash Perëndinë dhe mos të duash vendin që të ka lindur dhe rritur dhe njerëzit që banojnë në të. Sakrificat për të tjerët mund të kenë një kosto, por mendoj se ato do të sjellim më shumë gëzim dhe do ta plotësojnë jetën e tyre, sepse një jetë pa gëzim është një jetë e gjymtuar.

gazetatema.net